

KËSHILLA TË DOBISHME
PËR NJË JETË
TË LUMTUR

Abdurrahman ibën Nasir es-Saadi



Abdurrahman ibn Nasir Es-Sadi

KËSHILLA TË DOBISHME PËR NJË JETË TË LUMTUR

Përktheu: Besnik Hamiti

Përmbajtja e librit

Kaptina e parë: imani/besimi dhe punët e mira.	3
Kaptina e dytë: Angazhimi në ndonjë lloj aktiviteti apo në dije të dobishme.....	11
Kaptina e tretë: Të kujtuarit (dhikri) e shumtë e Allahut (Xhel-le XhelaluHu).....	15
Kaptina e katërt: Harrimi i gjërave të pakëndshme që kanë kaluar.	18
Kaptina e pestë: Përfytyrimi i situatave më të këqija. ...	21
Kaptina e gjashtë: Qëndrueshmëria e zemrës dhe mbështetja në Allahun ('Azze ue Xhel).....	23
Kaptina e shtatë: Zmbrapsja e së keqes me të mirë.....	26
Kaptina tetë: Mos lër që brenga dhe shqetësimi të ta shkurtojnë jetën tënde të shkurtër.....	29

Kaptina e parë: imani/besimi dhe punët e mira.

Mënyra themelore dhe më madhështore për arritjen e një jetese të mirë është imani dhe punët e mira. Allahu (‘Azze ue Xhel) thotë:

“Kush bën punë të mira, qoftë mashkull, qoftë femër, ndërsa është besimtar, vërtet që atij Ne do t'i japim një jetë të mirë; dhe Ne do t'i shpërblejmë ata sipas punëve më të mira që kanë bërë.” (en-Nahl, 97)

Pra, Allahu (‘Azze ue Xhel) informon dhe premton se, cilitdo që e bën bashkë besimin me punët e mira, Ai do t'i japë një jetë të mirë në këtë botë dhe një shpërblim të mirë si në këtë botë, ashtu dhe në Ahiret (botën tjetër).

Arsyeja mbrapa kësaj është shumë e qartë. Kjo sepse besimtarët e vërtetë në Allahun (‘Azze ue Xhel) të cilët kanë besim të shëndoshë që shtyn për punë të mira, që i përmirëson zemrat, ndreq sjelljen dhe e bën të mirë edhe këtë botë, edhe tjetrën, pra, njerëzit e këtillë kanë elementet bazë që i udhëzojnë ata në ballafaqimin me situatat e lumturisë dhe gëzimit si dhe situatat e ankthit, mërziës dhe shqetësimit.

Ata i pranojnë situatat e lumturisë e të gëzimit ndërsa janë mirënjohës dhe i shfrytëzojnë ato për atë që është e dobishme. Kur ata i shfrytëzojnë (situatat) në këtë mënyrë,

përrjetojnë një gëzim shtesë, i dëshirojnë bereqetet e këtyre gjërave dhe shpresojnë që ato të mbeten te ta duke qenë të etur për shpërblimin e mirë të atyre që janë mirënjohës ndaj Allahut (‘Azze ue Xhel). Kjo ndjenjë dhe përvojë sjell me vete të mira e bereqete të mëdha, shumë më të mëdha sesa gëzimi i cili është shkaku kryesor i saj.

Në anën tjetër, situatat e dëmshme dhe të pakëndshme, situatat e shqetësimit dhe mërzië ata i trajtojnë duke i rezistuar asaj që është e rezistueshme dhe duke lehtësuar atë që mund të lehtësohet, dhe ata qëndrojnë me një pranim/kënaqje të hijshme ndaj asaj të cilës s'mund t'i rezistojnë.

Më këtë ata arrijnë dobinë e mundit të madh ndërsa përfitojnë përvojë dhe forcë të brendshme, dhe arrijnë shpërblimin e durimit madhësia e të cilit nënvleftëson gjërat e pakëndshme që i godasin ata. Si rrjedhim, në vend të gjërave të pakëndshme, ata përfundojnë me gëzim e shpresë dhe me një dëshirë të sigurtë për favoret e Allahut (‘Azze ue Xhel) dhe shpërblimin e Tij. Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) e përshkroi bukur këtë situatë në një hadith sahih, ku tha:

“Puna e besimtarit përnjëmend është e mahnitshme. E gjithë puna e tij është e mirë. Kur ai është në rehati e qetësi, tregohet

mirënjohës dhe kjo është mirë për të; kur ai pëson ndonjë vuajtje, tregohet i duruar dhe kjo është mirë për të. Dhe kështu qëndron puna vetëm me një besimtar.” (Muslim)

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na informoi në këtë hadith se mirësia e besimtarit dhe fitimet e tij si dhe dobitë e shkëlqyera të punëve të tij shumëfishohen në të gjitha gjërat që e godasin atë, qofshin ato të këndshme, qofshin të pakëndshme.

Kjo është arsyeja pse ti mund të shohësh dy persona të preken nga rënie e ngritje jete të njëjta ndërsa dallojnë aq shumë në mënyrën sesi i trajtojnë ato në përputhje me nivelin e imanit të tyre dhe punëve të mira që bëjnë.

Ai që ka iman e punë të mira, e trajton edhe situatën e mirë edhe të keqen me atë që u përmend nga mirënjohja në situatat e mira dhe durimin në të këqijat, si dhe gjërat tjera që shkojnë me këto. Si rrjedhim, ai përjeton gëzim e lumturi, kurse shqetësimi e mërzia e lënë atë ndërsa çlirohet nga dhimbja, ankthi dhe shtrëngimi i zemrës, dhe ai e jeton një jetë të mirë e të lumtur në këtë botë.

Tjetri, në anën tjetër, përballet me situatat e gëzueshme e të këndshme me paturpësi, arrogancë e rebelim. Si pasojë, sjellja e tij devijon dhe ai bëhet si një kafshë, duke e trajtuar gëzimin me babëzi totale, me hap të

pandalshëm dhe etje të flaktë. Pavarësisht kësaj, zemra e tij nuk rehatohet. Ai është i shqetësuar për disa arsye: ai është i shqetësuar nga frika se e mira do të shuhet dhe nga brenga për mundin e fitimit të saj; ai është i shqetësuar nga etja e flaktë për të fituar më shumë, sepse uni njerëzor, nga natyra, nuk njeh kufij në atë që e dëshiron, dhe ai ose mund ta fitojë atë, ose jo; po edhe nëse ai e fiton atë, shqetësimi hala nuk pushon, sepse cikli do t'i përsëritet atij dhunshëm.

Pastaj, ai goditet me gjëra të pakëndshme: mërzitet, dëshpërohet, tutet e pikëllohet. Veç Allahu ('Azze ue Xhel) e di shkallën e mjerimit jetësor nëpër të cilin ai kalon dhe sëmundjen mendore që shkon krahas kësaj, si dhe përmasën

e frikës e cila përfundimisht çon në rezultate edhe më të tmerrshme. Kjo sepse ai as nuk ka ndonjë shpresë për shpërblim, as ndonjë durim që do ta ngushëllonte dhe do t'ia lehtësonte dhimbjet.

Krejt kjo dihet nga përvoja njerëzore. Ka shumë shembuj në jetë që, sikur të reflektoje qoftë edhe vetëm në njërin prej tyre dhe të vrojtoje përjetimin njerëzor gjatë tij, përfundimisht do të shihje dallimin e madh mes besimtarit të vërtetë, i cili vepron në përputhje me besimin e tij, dhe personit që s'është si ky. Kjo sepse feja e

së vërtetës nxit fort për kënaqje me furnizimin e Allahut ('Azze ue Xhel) dhe me çfarëdo që Ai u jep robërve nga bujaria e Tij.

Nëse besimtari goditet me sëmundje, fukarallëk a vuajtje të ngjashme, prej të cilave asnjë person nuk shpëton, ai është i lumtur dhe i kënaqur, për shkak të besimit që ka, kënaqjes dhe pranimit të asaj që Allahu ('Azze ue Xhel) ka dekretuar për të. Zemra e tij nuk e kërkon atë që s'është shkruar (caktuar) për të. Ai shikon në njerëzit që janë më pak fatlumë se ai e nuk shikon në ata që janë sipër tij në pasuritë e dunjasë. Nëpërmjet kësaj, ai, bile, mund të jetë më i lumtur dhe më i rehatshëm sesa ai që ka të plotësuarat të gjitha nevojat e dunjasë, por që nuk i është dhënë kënaqja (me atë që ka).

Të kundërtën e gjejmë tek ai që nuk vepron në përputhje me imanin. Kur ai goditet me fukarallëk apo humb diçka nga të nevojshmet e dunjasë, e gjen atë krejtësisht të dëshpëruar dhe të vrarë në shpirt.

Një shembull tjetër është kur frika dhe ngjarjet shqetësuese e godasin personin. E gjen personin me iman të ketë zemër të vendosur ndërsa është i qetë, dhe plotësisht kontrollon situatën duke përdorur si është më së miri aftësinë mendore, të folurit e të vepruarit, thuajse ai tashmë e ka përgatitur vetveten për ngjarjen. Kjo mënyrë e reagimit e bën atë të

rehatshëm dhe ia forcon zemrën.

Në anën tjetër, reagimi i atij që s'ka iman është i kundërt më këtë. Kur ai përballet me situata të frikshme, zemra e tij dridhet dhe ai nervozohet ndërsa mendja e tij humbet përqendrimin. Brenda tij s'ka gjë tjetër veçse alarm e frikë. Tmerri i jashtëm shtohet nga nervozizmi i tij i brendshëm shkalla e të cilit është përtej përshkrimit që mund t'i bëhet. Ky lloj njerëzish, nëse nuk përdorin diçka nga mjetet natyrore që janë në dispozicion të çdonjërit për t'u përballur me telashe nëpër përjetimet jetësore, energjia e tyre shpërthet dhe ata pësojnë kolaps nervor. Kjo sepse atyre u mungon imani që i nxit për durim, sidomos në situatat e vështira.

Është e vërtetë që edhe i miri, edhe i keqi; edhe besimtari, edhe ai që refuzon të besojë kanë të përbashkët cilësinë e fitimit të guximit dhe aftësinë e lindur për t'u përballur me situata të rënda dhe për të lehtësuar presionin nga vetja e tyre. Por, besimtari, për shkak të besimit të fortë, durimit e mbështetjes në Allahun ('Azze ue Xhel) si dhe dëshirës për t'u shpërblyer nga Allahu, dallohet me pasjen e cilësive që e bëjnë atë më të guximshëm dhe ia zbusin më shumë

sëmbimet e tmerrit dhe dhimbjet e fatkeqësisë që e godasin atë. Allahu ('Azze ue Xhel) thotë:

“Nëse ju përjetoni vështirësi, edhe ata (mosbesimtarët) përjetojnë vështirësi si ju, por

ju shpresoni nga Allahu atë që ata nuk shpresojnë.” (en-Nisa, 104)

Përveç kësaj, besimtari pranon nga Allahu ndihmë të posaçme dhe mbështetje që do ta zmbrapsë tmerrin që e godet atë. Allahu (Xhel-le XhelaluHu) thotë:

“Dhe jini të duruar. Vërtet, Allahu është me të duruarit.” (el-Enfal, 46)

Nga mënyrat për eliminimin e shqetësimit e mërziës është mirësia ndaj krijesave nëpërmjet fjalëve e veprave, si dhe nëpërmjet të gjitha llojeve të bamirësisë. Krejt këto janë të mira në shikimin e Allahut (‘Azze ue Xhel) dhe, nëpërmjet tyre, Allahu i largon shqetësimet dhe mërzitë si nga i keqi, ashtu dhe nga i miri; secilit në përputhje me nivelin e bamirësisë së tij ndaj krijesave.

Përveçqë hisja e besimtarit në këtë është më e plotë, ai, po ashtu, dallohet me faktin se kjo mirësi lindet nga singëriteti ndaj Allahut (‘Azze ue Xhel) dhe nga kërkimi i shpërblimit të Tij.

Si rrjedhim, Allahu (‘Azze ue Xhel) ia bën të lehtë aktin e mirësisë, për shkak të shpresës së tij për mirësinë që është tek Allahu, dhe largon prej tij gjërat e pakëndshme, për shkak të singëritetit që ka dhe kërkimit të shpërblimit të Allahut. Allahu (‘Azze ue Xhel) thotë:

“S’ka gjë të mirë në shumicën e bisedave të tyre të fshehta, përveç në atë i cili nxit për lëmoshë (në rrugë të Allahut) a mirësi apo për pajtim mes njerëzve. Kush e bën këtë duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, Ne do t’i dhurojmë atij shpërblim të pamasë.” (en-Nisa, 114)

Allahu (‘Azze ue Xhel) na informon se këto gjëra janë akte mirësie për këdo që i vepron. Dhe aktet e mirësisë u sjellin atyre të mira dhe ua largojnë të këqijat. Por, besimtarit të vërtetë, i cili është në kërkim të shpërblimit dhe kënaqësisë së Allahut (‘Azze ue Xhel), Allahu i jep një shpërblim të pamasë. Pjesë e këtij shpërblim të madh është largimi prej tij i shqetësimit dhe mërziisë...

Kaptina e dytë: Angazhimi në ndonjë lloj aktiviteti apo në dije të dobishme.

Nga mënyrat e largimit të shqetësimeve që lindin nga nervozizmi dhe preokupimi i zemrës me gjërat që të mërzhisin është që të merresh me ndonjë aktivitet apo me dije të dobishme. Kjo sepse me këtë do ta heqësh vëmendjen

nga ankthet në të cilat zhytet zemra. Kjo, bile, mund të bëjë që ai t'i harrojë gjërat që e kanë shqetësuar e mërzhitur dhe, bile, ai mund dhe të gëzohet. Por, besimtari është ndryshe, sepse, kur ai preokupohet me dije të cilën ai e kërkon apo e jep, apo me ndonjë punë të mirë që ai bën, qoftë kjo ndonjë akt adhurimi, qoftë ndonjë akt dunjaje me të cilin synon të forcohet në adhurimin ndaj Allahut ('Azze ue Xhel), pra, kur ta bëjë këtë, ai e bën nga besimi në Allahun, nga sinqeriteti dhe ngaqë kërkon kënaqjen e Allahut ('Azze ue Xhel). Kjo, në vetvete, ka ndikim shtesë në largimin e shqetësimit e të mërzhisë (nëpërmjet një intervenimi hyjnor).

Kemi parë shumë njerëz të vuajnë nga mërzhitë dhe shqetësimet e vazhdueshme deri në atë masë sa të sëmuren. Ilaçi i vetëm ishte që ata të harronin shkakun e mërzhisë dhe dhimbjes së tyre, si dhe të preokupoheshin me aktivitetet normale të tyre. Aktiviteti me të cilin duhet marrë duhet të jetë diçka e kënaqshme për personin dhe diçka për të cilën personi ka

interesim të madh.

Kjo e bën më efektive arritjen e synimit të dëshiruar, dhe e tërë dija vjen nga Allahu (‘Azze ue Xhel).

Nga gjërat që largojnë mërzinë dhe shqetësimin është përqendrimi në çështjet e së tashmes dhe të mos shqetësohesh për të ardhmen apo të pikëllohesh për të kaluarën. Për këtë arsye, peygamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kërkonte shpëtim tek Allahu (‘Azze ue Xhel) nga shqetësimi dhe pikëllimi. Pikëllimi, zakonisht, ndodh për ngjarjet e kaluara, të cilat as nuk mund t'i kthesh mbrapa e as t'i ndreqësh. Shqetësimi, zakonisht, është një frikë dhe merak për atë që pritët të vijë në të ardhmen.

Prandaj, njeriu duhet të jetë “bir i çastit” duke e përqendruar energjinë dhe synimin e vet në përmirësimin e ngjarjeve të pranishme dhe çasteve të tanishme. Përqendrimi i vëmendjes në çështjet e çastit është një shkak i domosdoshëm për përmbushjen e tyre, dhe kjo është ajo që heq pikëllimin dhe shqetësimin nga zemra.

Kur peygamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) kërkon diçka nga Allahu apo e udhëzon komunitetin e vet për të kërkuar një gjë të caktuar nga Allahu (‘Azze ue Xhel), ai i këshillon ata që, krahas kërimit të ndihmës nga Allahu dhe shpresës për favoret e Tij, njëkohësisht ata

duhet të punojnë fort për përmbushjen e asaj që duan të hiqet prej tyre. Prandaj, bërja e duasë duhet të shkojë krah për krah me veprimin.

Kështu, robi mundohet për atë që do t'i bëjë dobi në fenë dhe dunjanë e tij, dhe ai e lut Zotin për t'ia përmbushur nevojën dhe kërkon ndihmën e Tij në këtë.

Pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) tha:

“Mundohu për atë që do të bëjë dobi dhe kërko ndihmën e Allahut e mos u bë i paaftë. Nëse të godet diçka, mos thuaj: ‘Sikur ta bëja këtë e këtë, do të ndodhte kjo e kjo’, po thuaj: ‘Ky është vendimi i Allahut. Ai

bën çfarë të dojë.’ Kjo sepse (të thënë) ‘sikur’ i mundëson shejtanit të veprojë.” (Muslim)

Në këtë hadith, pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) na këshillon të bashkojmë dy gjëra: e para është të mundohemi për gjëra të dobishme në të gjitha situatat dhe të kërkojmë ndihmë nga Allahu (‘Azze ue Xhel) e të mos i dorëzohemi paaftësisë, sepse kjo është neglizhencë e dëmshme; e dyta është t'i dorëzohemi Allahut lidhur me ngjarjet e kaluara dhe të shohim në to vendimin/dekretin e Allahut dhe paracaktimin e Tij Shohim që pejgamberi (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem) përvijoi dy kategori të çështjeve: kategoria e parë janë çështjet të cilat robi ka mundësi t'i

përmbushë në tërësi apo pjesërisht, apo ato të cilave ai mund t'u shmanget tërësisht apo së paku ta lehtësojë barrën e tyre. Për këtë kategori robi duhet të japë mundin maksimal dhe të kërkojë ndihmë nga Zoti (Xheleshanuhu). Kategoria e dytë janë ato çështje ndaj të cilave robi s'ka kurrfarë mundësie. Për këtë robi duhet ta qetësojë vetveten, ta pranojë atë që i erdhi dhe të dorëzohet (Allahut). S'ka dyshim që ky është një parim zbatimi i të cilit përbën metodën e saktë për arritjen e lumturisë dhe kontrollimin e shqetësimit dhe pikëllimit.

Kaptina e tretë: Të kujtuarit (dhikri) e shumtë e Allahut (Xhel-le XhelaluHu)

Nga mënyrat më madhështore për zgjerimin e zemrës dhe qetësinë e kënaqësinë saj është të kujtuarit e shumtë të Allahut (‘Azze ue Xhel).

Të kujtuarit e Allahut ka një ndikim të mahnitshëm në realizimin e zgjerimit dhe qetësisë në zemër si dhe largimin e mërzisë dhe shqetësimit nga ajo. Allahu (‘Azze ue Xhel) thotë:

“Pa dyshim që në të kujtuarit e Allahut zemrat gjejnë prehje” (e- Rra’d, 28)

Kjo për shkak të ndikimit të jashtëzakonshme që të kujtuarit e Allahut ka në zemrën dhe në faktin se robi, kur e kujton Allahun, mban shpresën për pranimin e një shpërblimi të mirë nga Ai (‘Azze ue Xhel).

Ndër këto gjëra, po ashtu, është dhe deklarimi e përmendja e favoreve dhe e bekimeve të Allahut, si të dukshmet, ashtu dhe të padukshmet. S’ka dyshim që njohja e favoreve dhe e bekimeve të Allahut (‘Azze ue Xhel) si dhe të folurit rreth tyre është një mënyrë nëpërmjet së cilës Allahu largon mërzinë dhe shqetësimin nga zemra, si dhe e bën personin mirënjohës ndaj Allahut. Pozita e mirënjohjes, në vetvete, është një pozitë e epërsisë dhe e shkëlqesisë, pavarësisht përmasës së fukarallëkut a sëmundjes, apo

formave tjera të sprovave që e gëlltisnin atë. Kur ai të krahasojë favoret e pafundme dhe të

pallogaritshme të Allahut (‘Azze ue Xhel) ndaj Tij me gjërat e pakëndshme që e kanë goditur, ai sheh sa të vogla janë ato në krahasim me bekimet e Allahut (‘Azze ue Xhel) ndaj tij.

Në fakt, sprovat dhe çrregullimet janë të atilla që, kur robi të goditet me to dhe ai bën atë çfarë kërkohet prej tij nga durimi, pranimi e dorëzimi, barra e tyre bëhet e lehtë ndërsa dhimbja e tyre zbutet. Veç kësaj, shpresa që robi ka për shpërblimin e Allahut (‘Azze ue Xhel) dhe besimi i tij në faktin se ai po e adhuron Allahun duke qenë i duruar dhe duke pranuar atë me çka Allahu e ka sprovuar e ëmbëlsojnë hidhësinë e fatkeqësisë. Pra, ëmbëlsia e shpërblimit e bën atë të harrojë hidhësinë e durimit.

Nga gjërat më të dobishme në këtë aspekt, po ashtu, është të punuarit sipas mësimave të një hadithi të vërtetuar të pejgamberit (sal-lAllahu ‘alejhi ue sel- lem):

“Shiko ata që janë nën ty (në pozitën e dunjasë) e mos shiko ata mbi ty (në pozitën e dunjasë). Kjo është më e përshtatshme për ty që të mos përbuzësh favoret dhe bekimet e Allahut ndaj teje.” (Buhari & Muslim)

Sikur robi ta vente përballë vetes këtë mësim fisnik, do të kuptonte sa lart është ngritur dhe

favorizuar ndaj shumë njerëzve në mirëqenie dhe në të kursyerit nga sprovat, si në pasuri dhe në atë çka vjen bashkë me të. Dhe kjo është e vërtetë, pavarësisht se me çfarë gjendje kemi të bëjmë. Nëse ai e bën këtë, shqetësimi dhe mërzia i tij do të shuhen, ndërsa do të shtohet gëzimi e kënaqësia e tij me favoret dhe bekimet e Allahut ('Azze ue Xhel) me të cilat Ai e vendosi mbi shumë të tjerë.

Kaptina e katërt: Harrimi i gjërave të pakëndshme që kanë kaluar.

Nga shkaqet e domosdoshme për lumturi dhe ndalimin e mërzisë dhe shqetësimit është munda për të larguar gjërat që shkaktojnë mërzinë dhe marrja me ato që sjellin lumturinë. Kjo arrihet duke harruar gjërat e pakëndshme që kanë kaluar e që ai s'ka mundësi t'i kthejë mbrapsht, si dhe duke e ditur se preokupimi me to është i pakuptimtë, në fakt, kjo është marrëzi, kufizim (i vetvetes) dhe çmenduri. Prandaj, ai duhet të mundohet që të mos mendojë për këto gjëra.

Ai, po ashtu, duhet të mundohet që të mos merakoset për të ardhmen, të mos u kushtojë vëmendje iluzioneve të fukarallëkut, frikës e gjërave tjera të pakëndshme që ai imagjinon se do ta godasin në të ardhmen. Ai duhet të dijë se kurrkush nuk e di çfarë do të ndodhë në të ardhmen, qoftë mirë, qoftë keq;

qoftë dhimbje, qoftë kënaqësi; e tëra kjo është në Dorën e Allahut ('Azze ue Xhel). Robi s'ka kurrfarë kontrolli mbi këtë.

Krejt çka i takon atij është që ai të mundohet të përmbushë atë që i bën dobi në të ardhmen dhe ta largojë dëmin nga vetvetja. Ai, gjithashtu, duhet të dijë se, kur robi të largojë mendjen nga meraku për të ardhmen e çështjeve të tij dhe

mbështetet në Zotin e tij për përmirësimin e tyre dhe është i kënaqur që Zoti i tij ta bëjë këtë për të, pra, kur ta bëjë ai krejt këtë, zemra e tij do të qetësohet dhe gjendja e tij do të jetë e mirë, kurse mërzitë e shqetësimet do të shuhen.

Nga gjërat më të dobishme për të bërë lidhur me të ardhmen e çështjeve është të thuhet lutja që e thoshte pejgamberi (sal-lAllahu ‘alejhi ue sellem):

“O Allah, ma bëj të mirë fenë time e cila më është forcë dhe pathyeshmëri; ma bëj të mirë dunjanë në të cilën është jetesa ime; ma bëj të mirë ahiretin tim i cili është vendqëndrimi im përfundimtar; bëje jetën time shtim për mua në tërë atë që është e mirë, dhe bëje vdekjen time prehje për mua nga çdo e keqe.” (Muslim)

Dhe thënia e tij:

“O Allah, në mëshirën tënde shpresoj, kështu që mos më lër të mbështetem në veten time as sa një kapsallitje e syrit, dhe m’i ndreq të gjitha punët. Kurrkush nuk meriton të adhurohet veç Teje.” (Ebu Daud, me zinxhir të vërtetë)

Nëse robërit e thonë këtë dua, çka nënkupton kërkimin e përmirësimit të ardhmërisë së tij si në aspektin e fesë, ashtu dhe në çështjet e dunjasë, pra, nëse ai thotë këtë me zemër të pranishme dhe të vëmendshme e me nijet të singertë, krahas mundit maksimal për ta

arritur këtë, padyshim që Allahu do ta realizojë atë për çka ai i lutet dhe për çka mundohet. Si rrjedhim, shqetësimi i tij do të ndryshojë në një gjendje të lumturisë dhe kënaqjes.

Kaptina e pestë: Përfytyrimi i situatave më të këqija.

Nga gjërat më të dobishme që largojnë shqetësimet dhe sikletet, kur personi goditet nga ndonjë fatkeqësi, është që ai të mundohet t'i lehtësojë vështirësitë duke e imagjinuar gjënë më të keqe të mundshme që do të mund t'i ndodhte dhe të mundohet të durojë. Pastaj, ai le të mundohet fizikisht sa të mundet për ta lehtësuar vështirësinë. Duke u munduar për atë që do t'i sjellë dobi nëpërmjet përpjekjeve për të duruar, shqetësimet dhe sikletet e tij do të shuhen dhe ai do të ketë shfrytëzuar energjinë në arritjen e të dobishmes dhe mënjanimit të dëmshmes brenda aftësive normale njerëzore.

Kështu, nëse personi vrerohet nga ndonjë gjë e frikshme, nga ndonjë sëmundje, nga fukarallëku apo mungesa e nevojave, ai duhet të përballet me këtë vështirësi dhe duhet të mundohet të durojë sa më shumë që ka mundësi. Në fakt, ai duhet ta përgatisë vetveten për diçka edhe më të rëndë.

Kjo sepse përgatitja mendore për t'u ballafaquar me gjëra të pakëndshme i bën ato të më të lehta dhe e topit mprehtësinë e dhimbjeve. Puna qëndron kështu sidomos kur, veç kësaj, ai edhe fizikisht mundohet t'u shmanget atyre. Duke e bërë këtë, ai bashkon aktin e dyfishtë të përgatitjes mendore për ballafaqimin me

fatkeqësinë dhe mundin fizik për t'iu shmangur shqetësimeve, të cilat së bashku i shërbejnë atij për të hequr vëmendjen nga bezdia dhe sikleti i fatkeqësisë.

Ai, po ashtu, duhet të mundohet me zell të rimbushë energjinë e tij të brendshme në ballafaqimin me këto fatkeqësi. Veç kësaj, ai duhet që absolutisht të mbështetet tek Allahu ('Azze ue Xhel) në të gjitha rrethanat dhe t'i zërë besë Atij.

S'ka dyshim që këto gjëra ndihmojnë shumë në sjelljen e lumturisë dhe kënaqësisë së zemrës. Krahës kësaj, ne kemi atë të cilën shpresojmë ta fitojmë nga shpërblimi si në këtë botë, ashtu dhe në tjetrën.

Kjo dihet mirë nga përvoja dhe, kush e shijon këtë, e di mirë.

Kaptina e gjashtë: Qëndrueshmëria e zemrës dhe mbështetja në Allahun ('Azze ue Xhel)

Ndër ilaçet më efektive për çrregullimet mendore e nervore, bile dhe të sëmundjeve tjera të trupit, është qëndrueshmëria e zemrës dhe forca e saj si dhe mosshqetësimi dhe mostrazimi i saj nga iluzionet dhe imagjinatat e shkaktuara nga mendimet e këqija. Kjo sepse, kurdo që personi ia lëshon frerin imagjinatës dhe lejon zemrën e vet të trazohet nga ndikimet negative si frika, sëmundja, hidhërimi a konfuzioni lidhur me ndonjë situatë të dhimbshme, apo ndonjë shqetësim lidhur me ndonjë ndodhi të keqe apo ndonjë humbje të gjërave të dashura, pra, kurdo që ai e lejon këtë të ndodhë, sigurisht që kjo do ta hedhë atë në strofëllin e ankthit e të sëmundjeve fizike e mendore dhe në një kolaps nervor pasojat e të cilit janë të mirënjohura për të gjithë.

Kurdo që një person mbështetet në Allahun ('Azze ue Xhel) dhe nuk ia dorëzon zemrën e vet iluzioneve dhe nuk lë që atij t'i vejnë fre imagjinatat e liga ndërsa

mbështetet në Allahun dhe është i sigurt në favoret e Tij, si rezultat i këtyre veprimeve, prej tij do të largohen vuajtja e mërzia dhe nga ai do të largohen shumë sëmundje mendore e fizike, ndërsa zemra e tij do të përjetojë aso qetësie e

gëzimi sa nuk përshkruhet dot. Sa e sa spitale janë të mbushura me të sëmurë që vuajnë nga iluzionet mendore dhe imagjinatat e liga! Sa e sa personave të fortë ua kanë thyer zemrën këto gjëra, e të mos flasim për të dobëtit! I vetmi që shpëton nga kjo është ai, që Allahu (‘Azze ue Xhel) i ka dhënë mirëqenie dhe e ka udhëzuar për t’u ballafaquar më vetveten në arritjen e mënyrave të dobishme të forcimit të zemrës dhe për zmbropsjen e shqetësimeve nga ajo. Allahu (‘Azze ue Xhel) thotë:

“Kush i zë besë Allahut, Ai do t’i mjaftojë.” (et-Talak, 3)

Domethënë, Allahu i mjafton atij në tërë atë që e shqetëson lidhur me fenë dhe dunjanë e tij.

Personi që i zë besë Allahut (‘Azze ue Xhel), ka një zemër të fortë dhe nuk ndikohet nga iluzionet e as nuk trazohet nga ngjarjet, sepse ai e di se kjo vjen nga një zemër e dobët dhe është një akt dobësie dhe frike fiktive. Ai, gjithashtu, e di se Allahu (‘Azze ue Xhel) e ka garantuar atë që i zë besë Atij se do t’i mjaftojë tërësisht, kështu që ai është i sigurt në Allahun dhe është i bindur në premtimin e Allahut (‘Azze ue Xhel). Si rrjedhim, mërzia dhe shqetësimi i tij shuhet, vështirësia e tij zëvendësohet me lehtësi, pikëllimi i tij me lumturi, dhe frika e tij me paqe e siguri.

E lusim Allahun ('Azze ue Xhel) të na japë mirëqenie dhe të na veçojë nga fatkeqësitë, si dhe të na dhurojë forcë të zemrës dhe vendosmëri të saj në pasjen e një sigurie të njëmendtë në Allahun, nëpërmjet të cilës Ai u garanton atyre që i posedojnë këto furnizim të çdo gjëje të mirë dhe largimin e çdo gjëje të keqe e të ligë. Amin.

Kaptina e shtatë: Zmbrapsja e së keqes me të mirë.

Ka dy mësimë të rëndësishme për të mësuar nga thënia e pejgamberit (sal- lAllahu ‘alejhi ue sel-lem):

“Një besimtar (bashkëshorti) nuk duhet ta urrejë një besimtare (bashkëshorten). Nëse ai nuk e pëlqen një cilësi të saj, do ta dojë një tjetër.” (Muslim)

Së pari, kjo ofron udhëzim për sjelljen me bashkëshortet, shokët, kolegët dhe këdo me të cilin ti mund të kesh një marrëdhënie apo shoqërim. Kjo të mëson të përgatitesh që ta pranosh faktin se, cilido person me të cilin ti ke ndonjë lloj marrëdhënieje, sigurisht që do të ketë të meta, cilësi jo të mira apo diçka që ti

nuk do ta pëlqesh. Kështu, nëse e gjen këtë tek ai, mendo se çfarë të takon apo është e përshtatshme për ty të bësh lidhur me mbajtjen e marrëdhënieve dhe ruajtjen e lidhjes së dashurisë dhe dhembshurisë mes jush. Sill ndër mend cilësitë e tij të mira dhe rëndësinë që feja i kushton mbajtjes së marrëdhënieve të mira shoqërore. Duke mos i vënë re cilësitë e këqija dhe duke sjellë ndër mend të mirat, mbahen lidhjet dhe shoqëria e mirë, dhe ky është një tjetër burim i harmonisë.

Mësimi i dytë është se kjo të mëson të largosh vuajtjen dhe shqetësimin dhe bën që marrëdhënia të jetë e sigurtë dhe e ndershme, ku secila palë përmbushë obligimet ndaj tjetrës ndërsa mbahet harmonia mes tyre. Ai që nuk vepron sipas këtij mësimi të peygamberit (sal-lallahu 'alejhi ue sel-lem) dhe vepron të kundërtën duke i vërejtur cilësitë e këqija dhe duke i injoruar të mirat, pa dyshim që do të kaplohet nga mërzia dhe shqetësimet, dhe sigurisht që do të ndërpritet lidhja e dashurisë mes tij dhe atyre që ai i do, dhe shumë nga të drejtat e obligimet e secilës palë s'do të përfillen.

Shumë njerëz me aspirata të larta dhe energji të brendshme janë në gjendje të përgatiten për t'u ballafaquar me fatkeqësitë e vështirësitë me durim e qetësi. Por, kur përballen me çështje të vogla e të parëndësishme, ata shqetësohen dhe mërziten ndërsa zemrat e tyre humbasin qartësinë e të menduarit dhe trazohen. Arsyeja për këtë është se ata ishin në gjendje të përgatiteshin për t'u përballur me situata të mëdha ndërsa i injoruan të voglat dhe për pasojë gjërat të cilat ata i konsideronin si të parëndësishme i befasuan dhe ua prishën qetësinë.

Personi përnjëmend i fortë e përgatit vetveten për t'u ballafaquar edhe me çështjet e mëdha, edhe me çështjet e parëndësishme dhe kërkon ndihmë nga Allahu në këtë, dhe Ai ('Azze ue

Xhel) nuk e lë atë të mbështetet te vetvetja as sa një kapsallitje e syrit. Kur ai të bëjë këtë, çështjet e vogla i bën të lehta ashtu si edhe të mëdhatë, dhe ai ruan vetëpërmbajtjen, lumturinë dhe qetësinë.

Kaptina tetë: Mos lër që brenga dhe shqetësimi të ta shkurtojnë jetën tënde të shkurtër.

Personi i mençur e di se jeta e vërtetë e tij është jeta që e jeton në lumturi dhe rehati, dhe kjo përnjëmend që është e shkurtër. Prandaj, ai s'duhet ta bëjë atë më të shkurtër duke lejuar që brenga dhe ankimi për telashet t'ia marrin anën, sepse kjo është e kundërta e të jetuarit të vërtetë. Ai duhet të jetë shumë lakmues për jetën e vet, në mënyrë që pjesa më e madhe e saj të mos mbushet me derte e telashe. Në këtë s'ka dallim mes personave të mirë e të këqij,

përveçqë besimtari ka një kuptim më të plotë të këtij fakti dhe e shfrytëzon më mirë këtë si për të mirën e dunjasë, ashtu dhe për atë të Ahiretit.

Kur atij i ndodh diçka e pakëndshme apo ai tutet se do t'i ndodhë, ai duhet t'i kujtojë bekimet tjera të Allahut ('Azze ue Xhel) ndaj tij në fenë dhe në jetën e tij të kësaj bote, dhe t'i krahasojë këto me gjërat e pakëndshme. Nëse e bën këtë, ai do të kuptojë se sa të shumta janë bekimet e Allahut ndaj tij dhe sa të parëndësishme janë telashet që e kanë goditur.

Ai, gjithashtu, duhet ta krahasojë frikën e vet me të keqen që mund t'i ndodhë dhe me shumë mundësi tjera të sigurisë dhe shpëtimit nga ajo

e keqe që mund të ndodhë. Prandaj, ai nuk duhet të lejojë që një mundësi e dobët apo e parëndësishme të peshojë më shumë sesa mundësitë e shumta e më të forta.

Nëpërmjet kësaj, frika dhe shqetësimi i tij do të shuhet. Ai, po ashtu, duhet të llogarisë se do t'i ndodhë ndonjë telashe më e madhe e pastaj të përgatitet të përballë me të dhe të mundohet aq sa mundet për ta zmbrapsur atë, nëse nuk ka ndodhur, apo ta largojë a ta lehtësojë, nëse tashmë ka ndodhur.

Nga gjërat e dobishme që duhet mbajtur mend është të dish se ajo çfarë njerëzit bëjnë për të lënduar ty, sidomos përgojimet dhe e folmja tjetër e ligë, nuk do të të thyej, por atyre do t'u bëjë dëm. Mënyra e vetme që do të thyejë ty është kur ti preokupohesh me mërzinë lidhur me këtë dhe lejon që kjo të t'i kaplojë ndjenjat. Kur ti e bën këtë, kjo do të të dëmtojë ashtu siç i ka dëmtuar ata. Por, nëse nuk i kushton vëmendje kësaj, s'do të të dëmtojë në asnjë mënyrë.

Po ashtu, duhet ta dish se jeta jote i nënshtrohet mendimeve tua. Nëse ti i angazhon mendimet tua në atë që të bën dobi në fenë tënde dhe në dunjanë tënde, atëherë jeta jote do të jetë e mirë dhe e lumtur. Përndryshe, do të ndodhë e kundërta.

Ndër mënyrat më të dobishme për largimin e brengës është të ushtrosh vetveten që të mos i dëshirosh falënderimet dhe mirënjohjet nga dikush tjetër veç Allahut ('Azze ue Xhel).

Kështu, nëse ti i bën mirë dikujt që ka ndonjë të drejtë ndaj teje apo që s'ka ndonjë të drejtë ndaj teje, atëherë ta dish se marrëveshja jote është bërë me Allahun dhe mos i kushto vëmendje falënderimeve dhe mirënjohjeve të atij ndaj të cilit je treguar i mirë. Kjo është ashtu siç thotë Allahu ('Azze ue Xhel) lidhur me elitën e krijesave të Tij:

“(Ata thonë): Ne po ju ushqejmë vetëm për hir të Allahut. Ne nuk duam kurrfarë shpërblimi prej jush e as falënderim.” (el-Insan, 9)

Kjo është edhe më e rëndësishme, kur kemi të bëjmë me familjen, me fëmijët apo me ndonjë person tjetër që është i lidhur fort me ty. Kurdo që ti e bën shprehi largimin e së keqes nga ata, ti vetë rehatohesh dhe, po ashtu, i bën edhe të tjerët të rehatohen.

Ndër gjërat që e bëjnë jetën të lehtë për ty është që të ndjekësh një shteg të natyrshëm në përpjekjet tua për të bërë punë të mbara e të mira dhe të mos e shtrëngosh vetveten për të ndjekur një shteg të panatyrshëm që do ta mbushte zemrën me brenga e shqetësime, ndërsa ti nuk bën gjë në arritjen e pozita të larta. Krejt kjo ngaqë ti ndoqe një shteg të

shtrembër.

Dhe e tërë kjo është urtësi. Po ashtu, shfrytëzoji çastet e trazimit dhe ktheji ato në çaste ëmbëlsie. Nëpërmjet kësaj, ëmbëlsia e kënaqësisë tënde do të shtohet ndërsa telashet tua do të shuhen.

Bëje synim tëndin arritjen e gjërave të dobishme dhe mundohu t'i realizosh ato, dhe mos u kushto vëmendje gjërave të dëmshme. Kjo do të ta heqë vëmendjen nga gjërat që sjellin mërzi e shqetësim. Shfrytëzo çastet e kohës së lirë dhe të përqendrimit mendor për të kryer aktivitet e rëndësishme.

Kur të ndërmarrësh gjëra të dobishme, ti duhet t'i radhitësh ato sipas prioriteteve dhe rëndësisë që kanë. Gjej cila prej tyre kërkon të bëhet me urgjencë dhe atë që ti ke qejf të bëhet.

E kundërta e kësaj do të sjellë monotoni, lodhje dhe pezmatim. Kërko ndihmë në mendimin dhe këshillimin e mirë. Thuhet se ai i cili kërkon të këshillohet, kurrë nuk bëhet pishman. Studio me kujdes dhe plotësisht atë që synon ta bësh.

Kur të jesh i sigurt për të mirën që gjendet në të dhe ti vendos ta bësh atë, mbështetu në Allahun ('Azze ue Xhel) dhe dije se Allahu i do ata që i mbështeten Atij.

Lavdi Allahut, Zotit të botëve. Mëshira dhe bekimi i Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, mbi familjen e tij dhe mbi shokët e tij.